



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 295 Akti

Nr. 240 Vendimi  
Tiranë, më 24.02.2020

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Relatore</b>
<b>Xhensila Pine</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 24.02.2020, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Tomor Skreli**, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Neni “G”** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrativ i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

## **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.3.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” – nga i cili rezultoi se do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët, z. Olsi Komici, znj. Pamela Qirko dhe znj. Firdes Shuli. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere, znj. Pamela Qirko. Anëtar i zëvendësues i këtij trupi gjykues është komisionere, znj. Xhensila Pine.

**2.1** Me vendimin nr. 1, datë 21.3.2019, kryesues i trupit gjykues u zgjodh komisioneri, z. Olsi Komici.

**2.2** Anëtarja e çështjes, komisionere znj. Firdes Shuli me kërkesën e saj deklaroi konfliktin e interesit me subjektin e rivlerësimit, z. Tomor Skreli dhe gjithashtu në datë 18.3.2019 ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të këtij subjekti. Dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues deklaruan mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

**3.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është vendosur ngritja e trupit gjykues për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje të komisioneres, znj. Firdes Shuli. Në vijim, në datë 21.3.2019, trupi gjykues i ngritur për shqyrtimin e kësaj kërkesë, ka vendosur miratimin e kërkesës për dorëheqje të komisioneres, znj. Firdes Shuli, nga procesi i rivlerësimit të subjektit Tomor Skreli.

**4.** Pasi çështja i kaloi me zëvendësim komisionere, znj. Xhensila Pine, në cilësinë e anëtares, dhe u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga ana e saj, u vendos fillimi i hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Tomor Skreli.

**5.** Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Tomor Skreli, ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

**6.** Konstatohet se z. Tomor Skreli, në periudhën gusht 1978 – dhjetor 1979, ka ushtruar funksionin e N/Prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Lushnje; në periudhën dhjetor 1979 – mars 1983, ka ushtruar funksionin e N/Prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Tepelenë; në periudhën mars 1983 – dhjetor 1995, ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjirokastrë dhe për

periudhën korrik 1998, e në vijim ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

7. Subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli, me shkresën e datës 02.12.2019, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes, duke shpjeguar me detaje arsyet e tij. Kërkesa është bazuar në nenin 65/1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kjo shkresë i është dërguar për dijeni Komisionit të Pavarur të Kualifikimit<sup>1</sup>.

8. Në vijim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit administroi shkresën<sup>2</sup> e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të së cilës përcillej vendimi “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, z. Tomor Skreli”.

8.1 Komisioni vëren se, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 61, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.12.2019, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Tomor Skreli, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

## **II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

### **a. Orientimi i Kolegjit të Posaçem të Apelimit:**

9. Kolegji i Posaçëm Apelimit në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me insitutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën të ndryshme të tij, po kështu dhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

9.1 Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot, datë 04.12.2019.

<sup>2</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 10.12.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*prot., datë 20.01.2020.

<sup>3</sup> Referohu vendimit të KPA me nr.1/2018 (JR), datë 11.06.2018, paragrafëve 96 dhe 97 të tij.

## **b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje:**

**10.** Siç e kemi evidentuar më sipër, pranë Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit, në datë 4.12.2019 është depozituar kërkesa<sup>4</sup> e z. Tomor Skreli, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, - *për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes.*

**10.1** KLGJ, bazuar në kërkesën për dorëheqje të bërë nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.12.2019, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Tomor Skreli, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër. Për këtë vendim krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli.

**10.2** Në vijim, KLGJ<sup>5</sup> na përcjell informacionin e marrë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë<sup>6</sup>, sipas të cilit konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli, nuk ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 10.12.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”.

**11.** Sa më sipër Komisioni vëren se, konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi z. Skreli ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mbasi ky këshill ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, i cili ka marrë formë të prerë.

## **c. Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit:**

**12.** Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe moscënimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit 84/2016, në datë 29.1.2020, Komisioni ftoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit z. Tomor Skreli<sup>7</sup>, seancë e cila do të zhvillohej në datë 3.2.2020, ora 12:00, në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve), kati 0, slla B, Tiranë.

**12.1** Mbas dërgimit të njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli, në datë 30.1.2020, me komunikimin elektronik ndër të tjera parashtron se, [...] në datë 10.12.2019, KLGJ ka vendosur mbarimin e mandatit të tij dhe se ai është larguar nga detyra në datë 20.12.2019 [...].

**12.2** Në vijim të komunikimit me subjektin e rivlerësimit, në datë 30.1.2020<sup>8</sup> Komisioni i Pavaruar të Kualifikimit njofton z. Tomor Skreli se, në garantim të të drejtave themelore të tij, e fton në seancë dëgjimore për t’a dëgjuar në lidhje me procesin e rivlerësimit të ndjekur ndaj tij dhe se, seanca do të zhvillohet siç parashikohet në njoftimin përkatës. Komisioni i kërkoi subjektit të konfirmojë prezencën e tij ose të bëjë me dije nëse nuk dëshiron të paraqitet në seancë.

<sup>4</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2019.

<sup>5</sup> Shkresa me nr. \*\*\*prot., datë 27.1.2020.

<sup>6</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2020.

<sup>7</sup> E-maili i dërguar subjektit të rivlerësimit datë 29.1.2020.

<sup>8</sup> E-maili i dërguar subjektit të rivlerësimit datë 30.1.2020.

**12.3** Në datë 31.1.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Tomor Skreli, ndër të tjera bën me dije se, [...]është dakort me arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit nr. \*\*\*, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe se, nuk mund të paraqitet në seancë, por Komisioni mund të vazhdojë ndjekjen e procedurës përkatëse [...].

**12.5** Gjithashtu me postë elektronike të datës 3.2.2020, subjekti i rivlerësimit njofton Komisionin, siç e kish sqaruar edhe në komunikimin paraardhës, se ai nuk ka asnjë pretendim për vendimin e KLGJ-së për mbarimin e mandatin dhe deklaroi se nuk do të paraqitet në seancë megjithëse e konsideron veten të njoftuar. Subjekti i rivlerësimit konfirmon se kërkon ndërprejen e procesit të rivlerësimit.

**d. Ligji i zbatueshëm për ndërprejen e procedurës së rivlerësimit:**

**13.** Në germën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur ai jep dorëheqjen.

**14.** Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinim me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

**15.** Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

**16.** Neni 56, i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

**17.** Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

*"[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]"*

**18.** Me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i rivlerësimit dhe me shkresën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, z. Tomor Skreli "nga funksionet e magjistratit" dhe të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e këtij statusi në datën 10.12.2019. Gjithashtu, Komisioni mori dijeni edhe të faktit se subjekti nuk ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi.

**19.** Në këto kushte, referuar fakteve të evidentuara me lart, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Tomor Skreli, duhet të ndërpritet sipas nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

**20.** Në zbatim të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ftoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, i cili deklaroi mosparaqitjen e tij në seancë dhe konfirmoi se kërkon ndërprejen e procesit të rivlerësimit.

**20.1** Sa më sipër, në referim të germës b), të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative si edhe në konsideratë të faktit se subjekti i rivlerësimit u njoftua për zhvillimin e seancës dëgjimore, deklaroi mospjesmarrjen e tij dhe, konfirmoi kërkesën për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se, procedura administrative për këtë subjekt mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimi të seancës dëgjimore, pasi subjekti ka paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative.

**21.** Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Tomor Skreli, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelitimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 24.02.2020.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Pamela QIRKO**  
**Relatore**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Gledis Hajdini*